


FËMIJËT DUHET TË TRAJTOHEN



NË MËNYRË TË BARABARTË

FUQIA E POPULLIT

ENES (8), ERIN (8), LEONARD (8), AMAR (8), ALINA (8), DEVINA (8), ERISA (8), KLEA (8), ELSA (8)



Grupi ynë sot mëson për demokracinë

Fjala demokraci rrjedh nga gjuha greke që do të thotë „demos“ popull dhe „kratos“ pushtet. Kjo i bie se populli e ka fuqinë për të vendosur për shtetin e tij. Parimet e demokracisë janë: e drejta për të shprehur mendimin, liria, toleranca, paqja dhe respekti.

Po ashtu, edhe barazia dhe trajtimi i të gjithëve në mënyrë të barabartë pa dallime moshe, gjinie, feje, hyjnë në demokraci. E drejta për të votuar dhe për t'i zgjedhur përfaqësuesit tanë është një prej formave të demokracisë. Ne kemi të drejtë të votojmë nga moshë 18 vjeçare. Edhe ne nxënësit e klasës III-2 i zbatojmë parimet e demokracisë dhe mundohemi që ta respektojmë njëri-tjetrin.

ROLI YNË NË NJË SHTET DEMOKRATIK

Në fëmijët kemi të drejtat dhe përgjegjësitë tona. Në të drejtat tona bëjnë pjesë respekti për të tjerët, ndihma dhe sjellja e mirë ndaj tyre.

Ne si nxënës duhet të punojmë edhe më shumë dhe të mësojmë në mënyrë që të jemi sa më të sjellshëm dhe sa më të edukuar. Të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës duhet që t'i respektojnë rregullat dhe të kontribuojnë për shtetin e tyre.

Së bashku ne e bëjmë demokracinë, prandaj duhet që ta respektojmë kur dikush flet dhe ta shprehim mendimin tonë lirshëm.



Klasa III-2




Gazetarët e demokracisë

ZGJEDHJET NË DEMOKRACI

ELINA (8), JONA (8), SUAR (8), LEDION (8), AGIM (8), RION (8), SHPAT (8), ETNOS (9), VLERA (8)

Artikulli nga klasa jonë tregon për demokracinë dhe zgjedhjet



Balonat e zgjedhjeve demokratike


Demokracia është pushteti i popullit. Ajo ekziston në dy lloje. Ato janë demokracia direkte dhe demokracia përfaqësuese.

Në demokraci, qytetarët votojnë. Zgjedhjet janë procesi i votimit, ku qytetarët mbi moshën 18 vjeçare votojnë. Edhe në kur të arrijmë këtë moshë do të fillojmë të votojmë. Të gjithë njerëzit duhet të jemi të barabartë në votim.


Kemi dy lloje të zgjedhjeve, ato janë: zgjedhjet lokale dhe qendrore. Në zgjedhje lokale zgjedhet kryetari i komunës që udhëheq gjithë qytetin, ndërsa në zgjedhje qendrore zgjedhen deputetët për Kuvend. Kuvendi bën ligje të reja dhe miraton ato. Deputetët janë përfaqësuesit, të cilët punojnë në Kuvend. Që të jemi të gjithë të barabartë, secili nga ne duhet të votoj.



Zgjedhjet janë të rëndësishme



Vizatimi mbi zgjedhjet



Balena e demokracisë



Fëmijët në grup

TË JEMI AKTIV NË VENDIN TONË

ARIS (9), ELA (8), RITA (8), AMAR (8), DAMATISI (10), ADI (8), SUELA (8), ALBION (9)

Përgjegjësitë dhe të drejtat tona si qytetarë aktiv në vendin në të cilin jetojmë

Ne sot kemi mësuar për qytetarinë aktive. Qytetarë janë të gjithë banorët e një vendi. Qytetarët tanë kanë përgjegjësitë e tyre dhe i respektojnë rregullat. Përgjegjësitë tona janë: të ruajmë ambientin, të hedhim mbeturinat në vendin e duhur, të mos hedhim plehra në tokë, të ndihmojmë njëri-tjetrin, të mos grindemi, të kuptojmë njëri-tjetrin, ta pranojmë fajin tonë, të respektojmë rregullat, të pastrojmë dhomën tonë, etj. Po ashtu, ne të gjithë kemi të drejta të barabarta dhe ato janë: e drejta të luajmë, të mësojmë, të dalim, të ushqehemi, ne kemi të drejtë të strehohemi, ne kemi të drejtë dhe t'i bëjmë detyrat, etj.



Autorët e artikullit




Ne kemi të drejtë të lexojmë



Ne kemi shumë përgjegjësi



Qytetarët aktiv



Ne duhet të bashkëpunojmë

KUVENDI I KOSOVËS

BERNA (8), BENJAMIN (9), DENIS (8), ERION (7), ERZA (8), KORAB (8), LEDRI (8), KLEA (7), SARA (9)

Ne sot mësuam se si funksionon Kuvendi i Kosovës si dhe cilat janë funksionet kryesore të tij

Kosova ka sistem demokratik parlamentar, për këtë arsye Kuvendi i Kosovës është institucioni i cili vendos mënyrën se si duhet të funksionojë shteti unë, duke miratuar ligjet të cilat propozohen nga vetë deputetët, por po ashtu edhe nga Qeveria, Presidenti ose një numër i madh i qytetarëve (10 000).

ÇFARË FUNKSIONESH KA KUVENDI?

Kuvendi i Kosovës i ka disa funksione e ato janë: funksioni legjislativ (që miraton por mund edhe mos të miratoj ligjet të cilat i propozojnë deputetët, Qeveria, Presidenti dhe qytetarët. Funksion tjetër që ka Kuvendi është mbikëqyrja e Qeverisë (ku e vëzhgon Qeverinë se a është duke i zbatuar të gjitha detyrat që ka). Si funksion tjetër që ka Kuvendi është të përfaqësoj

popullin (siç e dijme deputetët, të cilët janë në Kuvend i përfaqësojnë njerëzit të cilët i kanë votuar për t'u bërë deputetë). Por, gjithashtu Kuvendi e miraton edhe buxhetin e Kosovës, të cilin e propozon Qeveria. Në Kuvendin e Kosovës i kemi gjithsej 120 deputetë që iu përkasin partive të ndryshme. Prej tyre 100 i takojnë shumicës në Kosovë, ndërsa 20 prej tyre i takojnë komuniteteve jo shumicë siç janë: komuniteti serb, ashkali, egjiptian, etj. Për këtë arsye, përveç gjuhës shqipe ne Kuvend fliten edhe tri gjuhë të tjera, që janë: gjuha serbe, angleze dhe turke.

Të gjitha këto që i mësuam ne si fëmijë do të na ndihmojnë kur të rritemi, sepse edhe ne një ditë do të jemi pjesë e Kuvendit të Kosovës.


Unë jam Erza dhe jam duke shkruar disa fakte për Kuvendin e Kosovës



Një punim ku na fregon se si funksionon Kuvendi



Foto nga grupi duke bashkëpunuar me njëri-tjetrin



Pyetje nga: Sara, Benjamina, Erjonit dhe Erza



Pyetje nga: Ledri, Klea, Korabi, Berna si dhe Denis



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „MODEL“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: III-2
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë